

Çka u gjet në Prelluzhë të Vushtrrisë?



17/10/2023 08:37



Një sasi armësh dhe municionesh janë gjetur mbrëmë në Prelluzhë të Vushtrrisë.

Kjo ka ndodhur gjatë pasdites së djeshme deri sa një qytetarë ishte duke mbledhur hekura në një vend ku hidhen mbeturinat ka hasur në armë zjarri e mjete shpërthyes.

Lidhur me këtë ai ka informuar Policinë e Kosovës dhe më pas këta të fundit kanë dal në vend të ngjarjes.

Sipas informative në vendin e ngjarjes njësitë policore pas një kontrole kanë gjetur një pushkë automatike AK-47, një pushkë gjysmë automatike, tre karikatorë, 360 fishekë të kalibrit 7.62 mm, 4 granata dore dhe një tromblon.


Po ashtu sipas informatave në vendin e ngjarjes prezent kanë qenë edhe njësitë relevante të FSK-së dhe KFOR-it.Mjetet shpërthyes janë tërheqë nga njësi i FSK-së, kurse armët dhe municioni janë tërheqë nga njësitë policore.

Lidhur me rastin është njoftuar prokurori i cili e ka bërë cilësimin e rastit dhe vazhdon të hetohet.

Nuk dihet nëse ky është një aksion tjetër i Policisë së Kosovës, apo kontroll rutinor.

Lajmi.net ka qëndruar në vendin e ngjarjes ku ka parë nga afër këtë moment. Për më shumë ndiqeni pamjet:[/Lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT




Osmani në konferencë thotë se është "kërcënuar", por nuk tregon emra



Gucati çon të fala nga oda e tij...



S'ka viza, Zana Avdiu: Vjosa Osmani e Albin...



"Ma e keqja o kon kur e kom...

Artikuj të ngjashëm




October 17, 2023

Osmani në konferencë thotë se është "kërcënuar", por nuk tregon emra



October 17, 2023

Gucati çon të fala nga oda e tij: Të fala ju...



October 17, 2023

S'ka viza, Zana Avdiu: Vjosa Osmani e Albin Kurti duhet të...



October 17, 2023

"Ma e keqja o kon kur e kom humb hotelin, por...



October 17, 2023

Publikohet vendimi tjetër: Nasim Haradinaj mbetet në burg



October 17, 2023

Ministri i Mbrojtjes i Turqisë mesazh Kosovës: Dialogu është rruga e...